



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Rruga "28 Nëntori", Shkodër (Shqipëri) Tel/Fax: 355 2224 2741,
www.qarkushkoder.gov.al, E-mail: qarkushkoder@yahoo.com,

PROGRAMI I TRANSPARENCËS
I
INSTITUCIONIT
TË
KËSHILLIT TË QARKUT
SHKODËR

I. HYRJE

Ka një diferencë të madhe mes asaj që kemi të drejtë të bëjmë dhe asaj që bëjmë.

Doktrona themelore e një demokracie të shëndoshë lidhet ngusht me dialogun e hapur dhe transparencën.

1.1. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij dokumenti është për të promovuar dhe çuar përpara parimet e transparencës dhe llogaridhënies nga Institucioni i Këshillit të Qarkut si shembull i qeverisjes së mirë.

Promovimi i një kuptimi më të mirë nga publiku i roleve dhe detyrave është sa një objektivi por dhe një sfidë për të gjithë institucionet e administratës publike në përgjithësi dhe të vet Institucionit të Këshillit të Qarkut Shkodër (tani e tutje KQSH). Në përputhje me mandatin e tij dhe kuadrin ligjor në bazë e për zbatim të cilit operon KQSH, informacioni në lidhje me KQSH duhet të jetë lehtësisht i arritshëm dhe relevant. Proçesi i punës, aktivitetet dhe produktet e KQSH duhet të jenë transparente. KQSH duhet të komunikojë hapur me mediat dhe palët e tjera të interesuara.

1.2. Koncepti i transparencës

Sundimi i ligjit dhe demokracia janë baza për një qeverisje që balancon drejt si

- ♦ pavarësinë në ushtrimin e funksioneve dhe kopetencave të saj
- ♦ ashtu dhe llogaridhënien në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e saj

Pavarësia, përgjegjshmëria dhe transparencja e KQSH janë parakushte thelbësore në një demokraci të bazuar në sundimin e ligjit dhe për të mundësuar KQSH për të qeverisur dukë dhënë shembull dhe për të rritur kredibilitetin e tij.

Llogaridhënia është një nga elementët më të rëndësishëm të qeverisjes së mirë.

Transparenca është aq e rëndësishme saqë kur zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, mund të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e qeverisjes dhe nxitjen e llogaridhënies.

Nocioni i transparencës ka të bëjë me raportimin në kohë, të besueshëm, të qartë dhe relevant mbi statusin, mandatin, strategjinë, aktivitetet, menaxhimin financiar, operacionet dhe performance të KQSH. Përveç kësaj, ajo përfshin detyrimin e raportimit publik mbi gjetjet e auditimit dhe përfundimet si dhe aksesin publik të informacionit në lidhje me KQSH.

II. PARIMET E PËRGJITHSHME

Rruga drejt një zhvillimi të qëndrueshëm kalon dhe nëpërmjet zbatimit të parimeve administrative të parashikuara në kushtetutë, akte ligjore e nënligjore. Për këtë nevojitet paketa e duhur ligjore që do garantojë implementimin e parimeve kushtetuese, pra dhe të parimeve të procedurave administrative që Kushtetuta parashikon.

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së KQSH lidhet ngusht me vet parimet ku mbështetet veprimtaria e organeve të adminstartës publike, Kodin e Procedurave administrative, ku parimet bazë janë:

1. Parimi i ligjshmërisë.¹
2. Parimi i transparencës²
3. Parimi i informimit³
4. Parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror⁴
5. Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit⁵
6. Parimi i mbrojtjes së të dhënave⁶
7. Parimi i dhënies së ndihmës aktive⁷

¹ Neni 4 i KPA

² Neni 5 I KPA

³ Neni 6 po aty

⁴ Neni 7 po aty

⁵ Neni 8 po aty

⁶ Neni 9 po aty

⁷ Neni 10 po aty

8. Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit⁸
9. Parimi i proporcionalitetit⁹
10. Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë¹⁰
11. Parimi i objektivitetit¹¹
12. Parimi i përgjegjësisë¹²
13. Parimi i marrjes së vendimeve¹³
14. Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit¹⁴
15. Parimi i deburokratizimit dhe i efijencës¹⁵
16. Parimi i mospagimit në procedurat administrative¹⁶
17. Parimi i kontrollit¹⁷

⁸ Neni 11 po aty

⁹ Neni 12 po aty

¹⁰ Neni 13 po aty

¹¹ Neni 14 po aty

¹² Neni 15 po aty

¹³ Neni 16 po aty

¹⁴ Neni 17 po aty

¹⁵ Neni 18 po aty

¹⁶ Neni 19 po aty

¹⁷ Neni 21 po aty

III. KATEGORITË E INFORMACIONIT QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Në bazë e për zbatim të ligjit **Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”**, në përputhje me Programin e Transparencës të miratuar KQSH, ky i fundit parapërgatit, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vë në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit, pa kërkesë, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- a. Përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të Institucionit të KQSH;
- b. Tekstet e plota:
 - i. *të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;*
 - ii. *të ligjeve;*
 - iii. *të akteve nënligjore;*
 - iv. *të kodeve të sjelljes;*
 - v. *të çdo dokumenti politikash;*
 - vi. *të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;*
- c. Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- d. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KQSH, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;
- e. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes,

kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

- f.** Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi KQSH, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së KQSH;
- g.** Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
- h.** Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit Nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të KQSH, duke përfshirë:
 - i. listën e kontratave të lidhura;*
 - ii. shumën e kontraktuar;*
 - iii. palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
 - iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;*
- i.** Informacion për shërbimet që KQSH i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;
- j.** Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e Institucionit të KQSH;
- k.** Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në

hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

l. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor KQSH për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i. registri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

ii. një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës së dhënë nga KQSH ndaj të tretëve dhe të procedurave për t'i përfituar ato;

iii. informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

m. çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga KQSH.

KQSH krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në Programin e miratuar të Transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga KQSH.

Informacioni i publikuar në faqen e internetit të Institucionit të KQSH përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Struktura organizative, funksionet dhe detyrat e KQSH.	Neni 7/1/a/d	VKM nr. 943 datë 09.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë së MIAP”; Skemë organizative, Organika/ Urdhër nr. 204, datë 1.11.2013 “Per miratimin e strukturës dhe të organikës së Kryeministritë.	Menjëherë pas miratimit të aktit dhe hyrjes në fuqi të tij	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Ligje dhe akte nënligjore; Strategji; Urdhra të Kryetarit/es; Raporte.	Menjëherë pas miratimit të aktit dhe hyrjes në fuqi të tij	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Format ankese Adresë postare: Këshilli i Qarkut Shkodër Rr: 28 Nëntori Shkodër Adresë e-mail: qarkushkoder@yahoo.com	Në faqen zyrtare KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KQSH, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Shpjeguese Të dhënat e koordinatorit	Koordinatori për të drejtën e informimit i KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të	Neni 7/1/d	Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”	Menjëherë pas përfundimit të	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit

funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.		Urdhër emërimi	procedurës së përcaktuar në ligj Pas miratimit të titullarit		të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Mekanizmat monitorues; raporte auditi; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raportim sipas planit të punës për periudhën në vazhdim.	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Buxheti	Neni 7/1/e	Ligji nr. 147/2015 “Për Buxhetin e 2016”	Menjëherë pas miratimit të aktit dhe hyrjes në fuqi të tij	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Funksionon brënda strukturës së KQSH	Funksionon brënda strukturës së KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Drejtoritë përkatëse, dokumentet mbi shërbimet që ofrojnë	Menjëherë me miratimin e shërbimeve	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Dokumentet përkatëse	Pas miratimit të akteve, vendimeve	www.inovacioni.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Mbajtja e dokumentacionit nga KQSH	Neni 7/1/h	Tabelë	Pas miratimit të dokumentave nga Titullari i KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji Nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Tabelë	Pas miratimit të dokumentave nga Titullari i KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Informacione të ndryshme, kryesisht informacione të cilat lidhen me fushën e përgjegjesisë së KQSH.	Pas miratimit nga MIAP të përgjigjes mbi kërkesën e subjekti fizik/juridik të interesuar	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Ankesa Kërkesa Materiale ndërgjegjësuere dhe evente	Pas miratimit të Titullarit të KQSH	www.qarkushkoder.gov.al	Koordinatori Grupi i monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH

V. PUBLIKIMI

Në bazë e për zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore për këtë qëllim, në bazë e për zbatim të Këtij Programi Transparence të miratuar, KQSH vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.qarkushkoder.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Në bazë e për zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore për këtë qëllim, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

Në bazë e për zbatim të Këtij Programi Transparence të miratuar, KQSH cakton Grupin e monitorimit të faqes zyrtare të internetit të KQSH.

K R Y E T A R E

Greta BARDELI